- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4.					
				Çmimi total	_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkreisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6 .

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen:

Shërbime mbështetëse për aktivitetin e çeljes së sezonit				
Nr.	Lloji i shpenzimit	Njësia	Sasia	Çmimi r
SHPENZIMET SIPAS ZËRAVE				
I. PROMOCIONI DHE DUKSHMËRIA				
1	Printim ftesa me permasa 12 x 17 cm printim ne 2 anet leter speciale me relief	cope	500	
2	Printim fletepalosje ne leter 130 gr format A 4 me 3 palosje e printuar nga te 2 anet	cope	700	
3	Printim certifikata per pjesemarrje A 4 Leter 300 gr	cope	100	
4	Prodhimi i bluzave me mende te shkurta ngjyre te bardhe material 100% pamuk me logon e Aktivitetit	cope	300	
5	Printim profesional ne forex ne permasa 50x70cm i materialeve ekspozuese arkivore dhe fotografike	cope	40	
6	Printim banderola me unaza dhe litar me permasa 1500 cm x75cm	cope	4	
7	Feneret e qielit(balona ndricues) (materiale dhe prodhim	cope	700	
8	Prodhim Trofe printim ne uv dhe preje laser sipas formes per fituesi	cope	10	
9	Prodhim Medalje me rrip cope broz m ar dhe silver per fituesit	cope	10	
II. MBULIM MEDIATIK DHE SHERBIME AUDIOVIZUALE				
1	Mbulim mediatik (realizimi i promovimit te eventit marketimi ne rrjete sociale dhe ne 10 media kombetare	Sherbim	1	
2	Projeksion me qira 21 K per kinemane verore per 3 dite	cope	1	
3	Strukture Layher me qira me permesa 8mx5m per 3 dite	cope	1	
4	Cope projektimi me qira me permasa 8mx5m format 16 :10 per 3 dite	cope	1	
5	Sistem Audio me qira per 3 dite (1 perbera nga 6 Boks per Sistem te vogel audio line array 8inch, 4 Subwoofer Double 18 inch , 2 Amplifikator Fuqie 8 kanalesh , 1 mixer 16 chanel, 2 mic wireless dhe 1 laptop)	cope	1	
6	Gjenerator 360 KWA me qira per 3 ditet	Sherbim	1	
7	Realizim i Xhirimit te eventit me regji 4 K me 5 kamera 1 dron per 3 ditet e aktivitetit	sherbim	1	
8	Ekip me 3 fotograf profesionist per 3 ditet e aktivitetit	sherbim	1	
9	Realizim spoti promovues aktiviteti 1- 2 minuta Hight Quality Rresolution 4 K	Sherbim	1	
10	Realizim i videove reels per rrjete sociale minutash 50 sekonda secila	Sherbim	20	
11	Video permbledhese te seciles dite 4 K High Quality 90 sekonda	Sherbim	3	
III. SHPENZIME TEKNIKE				
1	Tenda me qira ne format 4mx4m per 3 dite	cope	30	
2	Karrige me qira 3 dite	cope	120	
3	Tavolina me qira me permasa 2mx1m 3 dite	cope	60	
4	Kavaleta me qira per 3 dite per mbajtjen e forekseve	cope	40	
			20%	T
				VLEP

Përgatiti Preventivin

Rolika Doka
Jon Allkushi

Afatet e ekzekutimit: 3 (tre) ditë

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit

TERMAT E REFERENCES

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

Himara çel sezonin turistik me një festë madhështore plot energji, kreativitet dhe frymë mesdhetare, që do të zgjojë interesin e vizitorëve të shumtë. Ky aktivitet synon të kthejë qytetin bregdetar në një skenë të gjallë kulturore, turistike e sportive, ku tradita dhe moderniteti takohen nën dritën e detit kristal dhe ritmet e verës. Nën sloganin “ Aty ku dielli prek detin”, do të prezantohet si një destinacion me bukuri të papërshkrueshme, ku natyra ka krijuar peizazhe të mrekullueshme dhe ku valët e detit puthin brigjet e gurta. “ Çelja e sezonit turistik ” do të zgjasë tre ditë, do të jetë një festë dinamike dhe shumëdimensionale, ku do të ndërthuret arti, sporti, tradita dhe argëtimi. Vizitorët vendas edhe të huaj do të kenë mundësi të shijojnë koncerte gjigante me emrat më të njohur të muzikës shqiptare dhe të huaj, aktivitete për fëmijë dhe hapësira lojërash, panair artizanati dhe tradita me produkte lokale dhe punime unike, panair kulinarie me gatime tradicionale dhe eksperiencia gastronomike, turne sportive: volejbolli plazhi, minimaratoni, aktivitete ujore, jetski, skuba – divng, eksperiencia detare, sfida gatimi me shefa të njohur të kuzhinës shqiptare, fun kids zone, facepainting, kinema verore, animacione, surpriza artistike workshope arti dhe performanca akrobatike që ndezin atmosferën mes detit dhe qiellit. Ky aktivitet kulturor, sportiv dhe artistik synon të kthejë Himarën në qendrën e energjisë, argëtimit dhe traditës mesdhetare, duke ofruar një përvojë të paharrueshme për çdo vizitor dhe duke vendosur një standard të ri për eventet turistike në vend.

Çelja e sezonit turistik është një mundësi e shkëlqyer për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe të ekonomisë lokale, duke promovuar kulturën dhe bukurinë natyrore të Himarës, një perlë e vërtetë mes detit dhe maleve. Slogani “ Aty ku dielli prek detin” ndërlihd lokacionin, emocionin, identitetin dhe eksperiencën turistike dhe e vendos Himarën në qendër të hartës turistike me një imazh të fortë dhe tërheqës. Kjo përfaqëson identitetin unik dhe emocionin që Himara ofron si hyrje e Rivierës Shqiptare dhe një nga pikat më të veçanta të jugut të vendit. Ky mesazh simbolizon fillimin e një eksperiencë të paharrueshme, ku bukurinë natyrore, deti me ujëra kristal, peisazhi mesdhetar, kultura lokale, tradita dhe mikpritja e veçantë bashkohen për të krijuar një atmosferë magjike. Ky aktivitet synon jo vetëm të promovojë Himarën si destinacion turistik, por edhe të përcjellë emocionin e veçantë që vizitorët përjetojnë sapo mbërrijnë në Himarë, një vend ku pushimi, aventura, argëtimi dhe kultura ndërthuren në mënyrë të përsosur. Me këtë qasje, Himara pozicionohet si pika e nisjes së një udhëtimi plot dritë, energji dhe përjetime unike, duke u shndërruar në destinacionin ku fillon magjia e jugut.

Ky aktivitet synon të ndërthurë artin, turizmin, artizanatin, sportet dhe gastronominë për ta prezantuar Himarën si një destinacion turistik modern, atraktiv dhe të shumëllojshëm. Qëllimi kryesor është krijimi i një eventi multidisiplinar që jo vetëm të tërheqë vizitorë nga brenda dhe jashtë vendit, por edhe të ofrojë një mundësi të vlefshme për angazhimin dhe fuqizimin e të rinjve në aktivitete kulturore, krijuese dhe sportive. Nëpërmjet këtij aktiviteti do të nxisim bashkëpunimin e ngushtë me komunitetin, bizneset lokale dhe autoritetet vendore, për të siguruar mbështetje logjistike dhe organizative. Një rol i veçantë do t'i kushtohet përfshirjes aktive të rinisë himariote, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësi menaxheriale, artistike dhe sportive, si dhe të rrisin ndërgjegjësimin për rëndësinë e kulturës dhe natyrës së zonës.

Promovimi i festivalit do të mbështetet nga një platformë komunikimi në rrjete sociale, ku do të publikohen materiale prezantuese, video artistësh dhe sportistësh, si dhe informacione për programin dhe pjesëmarrësit. Po ashtu, do të realizohet partneritet me agjenci turistike të zonës, për të ofruar paketa të dedikuara që përfshijnë akomodim, aktivitete dhe guida lokale, duke e pozicionuar Himarën si një pikë referimi për turizmin kulturor dhe sportiv.

Programi sportiv dhe kreativ do të përfshijë aktivitete si minimaratonë, zhytje nënujore, gara me jetski, beach volley dhe aktivitete të tjera që promovojnë aktivizimin fizik dhe eksplorimin e natyrës. Paralelisht, të rinjtë do të kenë mundësinë të prezantojnë punimet e tyre artistike dhe krijuese, duke pasuruar dimensionin kulturor të festivalit. Ky event synon të shndërrohet në një pikë takimi për kulturën, artin dhe natyrën, duke forcuar imazhin e Himarës ndërkombëtarisht dhe duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe promovimin e vlerave të rajonit jugor të Shqipërisë.

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I AKTIVITETIT

Qëllimi i këtij aktiviteti është të **promovojë potencialet turistike dhe kulturore të Himarës**, duke integruar artin, turizmin dhe kulturën për të ofruar një përvojë të pasur dhe shumëdimensionale për vizitorët dhe komunitetin. Ngjarja synon të kontribuojë në **zhvillimin e turizmit, rritjen e ekonomisë lokale** dhe angazhimin e komunitetit, veçanërisht të rinisë himariote.

Përmes aktiviteteve të ndryshme si **gara sportive, workshope, panaire artizanati dhe kulinarie, ekspozita, koncerte dhe evente kulturore**, ky aktivitet promovon jo vetëm bukurinë natyrore të Himarës, por edhe lidhjen mes artit, traditës dhe turizmit. Mundësitë për pjesëmarrje në **sfida gatimi, gara sportive dhe konkurse për fotot dhe videot më të mira** synojnë të stimulojnë krijimtarinë dhe të angazhojnë brezat e rinj në zhvillimin e industrisë së turizmit dhe kulturës lokale.

Qëllimi i përgjithshëm është të **rishfaqë Himarën si një destinacion të pakrahasueshëm**, të rrisë vizitueshmërinë, të mbështesë ekonominë lokale dhe të ruajë trashëgiminë natyrore dhe kulturore. Me një organizim të tillë, Himara ofron **përvoja unike, aventurë, kulturë dhe relaks** për turistët, duke e bërë qytetin një destinacion të preferuar për të gjithë ata që duan të përjetojnë bukurinë natyrore dhe trashëgiminë e pasur shqiptare.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË AKTIVITETIT

Ky aktivitet ka disa objektiva specifike të cilat kontribuojnë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit dhe kulturës në Himarë.

Promovimi i Turizmit dhe Kulturës

- Ky aktivitet ka për qëllim të nxjerrë në pah bukuritë natyrore, historike dhe kulturore të Himarës dhe tërheqjen e turistëve nga brenda dhe jashtë vendit.

Forcimi i Identitetit Lokal dhe Trashëgimisë Kulturore

- Ruajtja dhe promovimi i traditave, kulturës dhe artizanatit lokal.
- Të krijojë hapësira ku arti, muzika, gatimi tradicional dhe kultura lokale prezantohen dhe vlerësohen.

Zhvillimi dhe Promovimi i Disiplinave Sportive

ritja e Pjesëmarrjes dhe Interesit në Gara dhe Aktivitete Sportive

- Zhvillimi i garave dhe sfidave sportive si beach volleyball, jetski, minimaratonë, skuba-diving, etj që përfshijnë pjesëmarrës nga komuniteti lokal dhe turistik.

- Ofrimi i mundësive për trajnime dhe aktivitete për të rinjtë dhe turistët që janë të interesuar në sporte të ujit dhe aktivitete outdoor.

- Promovimi i llojeve të ndryshme të sporteve si mjet për zhvillimin e turizmit aktiv në Himarë dhe për të rritur angazhimin e vizitorëve dhe banorëve në aktivitete sportive dhe aventuristike.

Nxitja e sportit si një vlerë komunitare dhe atraksion turistik.

Fuqizimi i Rinisë Lokale

- Angazhimi aktiv i të rinjve himariotë në organizim, pjesëmarrje dhe menaxhim të aktivitetit.

- Zhvillimi i aftësive kreative, menaxheriale, sportive dhe sociale tek të rinjtë.

Aktivizimi i Komunitetit dhe Bashkëpunimit Lokal

- Nxitja e bashkëpunimit midis autoriteteve vendore, bizneseve lokale, komunitetit dhe organizatave të shoqërisë civile.

- Forcimi i frymës së komunitetit dhe pjesëmarrjes qytetare.

Rritja e Ekonomisë Lokale

- Mbështetja e bizneseve vendase përmes rritjes së fluksit të vizitorëve dhe konsumit lokal.

- Krijimi i mundësive për sipërmarrje dhe punësim të përkohshëm, sidomos për të rinjtë.

Rritja e Kreativitetit dhe Pjesëmarrjes Publike

- Ndërmarrja e aktiviteteve konkurruese (sfida gatimi, gara sportive, etj) për të nxitur krijimtarinë dhe përfshirjen e publikut.

- Mbështetja e talenteve të rinj të artit, medias dhe sportit.

Promovimi përmes Platformave Dixhitale

- Përdorimi i mediave sociale për marketing, komunikim dhe dokumentim të eventit.

- Rritja e vizibilitetit të Himarës në tregun turistik kombëtar dhe ndërkombëtar.

Promovimi i Gastronomisë dhe Traditave Kulinarike Lokale Himariote

- Zhvillimi i garave të gatimit dhe shfaqjeve kulinarike që pasqyrojnë gatimet tradicionale të rajonit jugor, duke ofruar një mundësi për të nxjerrë në pah trashëgiminë kulturore dhe për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e ruajtjes së traditave kulinare të Himarës.

- Ofrimi i mundësive për turistët të provojnë receta tradicionale dhe të marrin pjesë në gatime të udhëhequra nga kuzhinierë lokalë.

Ky festival synon të shndërrohet në një ngjarje të rëndësishme multifunktionale, që bashkon turizmin, artin, kulturën dhe sportin, duke krijuar mundësi për zhvillim të qëndrueshëm dhe bashkëpunim mes komunitetit, vizitorëve dhe sektorit turistik. Përmes objektivave të tij, festivali synon të forcojë identitetin kulturor të Himarës, të gjenerojë vlera ekonomike dhe të rrisë prezencën e saj në hartën turistike. Ky aktivitet aspiron të kthehet në një element të përhershëm të kalendarit të ngjarjeve në Himarë, duke sjellë vëmendje, mundësi zhvillimi dhe përfitime afatgjata për zonën dhe komunitetin vendas.

GRUPET E SYNUARA

Grupet e synuara për këtë aktivitet do të përfshijnë një gamë të gjerë individësh që kanë interesa dhe lidhje me turizmin, kulturën, sportin dhe zhvillimin ekonomik të Himarës. Ky aktivitet është një mundësi për të bashkuar një audiencë të gjerë dhe të ndryshme, duke përfshirë komunitetin lokal dhe vizitorët, si dhe duke krijuar një hapësirë për bashkëpunim dhe zhvillim.

Ndër grupet e synuara në këtë aktivitet janë;

1. Turistët dhe Vizitorët vendas dhe të huaj

Tërheqja e turistëve është një nga synimet kryesore për aktivitetet kulturore, pasi ato janë një mundësi për të promovuar destinacionin dhe për të zhvilluar turizmin. Ky aktivitet është një mundësi për të tërhequr vizitorë nga jashtë, duke i ofruar një eksperiencë të veçantë dhe autentike të Himarës, ku mund të shijojnë natyrën, kulturën, sportin, artin dhe gatimet tradicionale.

2. Banorët lokalë të Himarës dhe fshatrave përreth:

Aktivitetet do të mundësojnë pjesëmarrjen e banorëve të Himarës dhe fshatrave turistike, duke i inkurajuar ata të marrin pjesë në organizimin e aktiviteteve, si dhe të kontribuojnë në zhvillimin e turizmit dhe kulturës lokale. Aktivitete të Përshtatshme: Punëtori artizanale, minimaratone, panaire, aktivitete edukative për tradita lokale, shfaqje dhe aktivitete që pasqyrojnë kulturën dhe historinë e rajonit.

3. Të Rinjtë dhe Studentët

Rinia është një grup kyç që kontribuon dhe përfshihet në zhvillimin e këtij aktiviteti si dhe të përfitojë nga mundësitë edukative që ofrohen nga organizimi i aktiviteteve të ndryshme. Aktivitetet sportive dhe sfidat e ndryshme, si gara maratonë vrapimi, beach volleyball, etj do të mundësojnë përfshirjen e rinisë lokale, duke i angazhuar ata në aktivitete fizike dhe promovuar një mënyrë jetese aktive.

4. Artizanët Himariotë “Duar artët”

Piktorët dhe artizanët himariotë janë të përfshirë në promovimin dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore, duke ofruar mundësi për tregtimin e produkteve të tyre dhe për zhvillimin e aftësive të tjera krijuese. Aktivitete të Përshtatshme: Panaire kulinarie dhe artizanati, ekspozita të artit, shfaqje me produkte të krijuara nga artizanët dhe mundësi për shkëmbime kreative mes tyre.

5. Familjet dhe Fëmijët

Angazhimi i grupeve familjare dhe fëmijëve është një pjesë e rëndësishme për të siguruar një audiencë të gjerë dhe për të mësuar brezat e rinj për traditat dhe artin. Aktivitete të Përshtatshme: Workshop-e për art dhe krijimtari për fëmijë, aktivitete për ndihmën e fëmijëve të zhvillojnë aftësitë krijuese, aktivitete të natyrës që lidhin mjedisin dhe kulturën.

6. Mediat dhe Publiku i Gjerë

Angazhimi i mediave dhe i audiencës më të gjerë do të ndihmojë në promovimin dhe shpërndarjen e informacionit mbi aktivitetet kulturore që do të zhvillohen dhe rezultatet e festivalit. Aktivitete të Përshtatshme: Konferenca për shtyp, PR në Media Sociale, intervista me pjesëmarrësit dhe organizatorët, publikime dhe mbulime mediatike për të rritur ndërgjegjësimin për aktivitetet dhe ngjarjet kulturore.

7. Gastronomët dhe kuzhinierët profesionistë

Kuzhinierët profesionistë që janë të interesuar të demonstrojnë aftësitë e tyre në kuzhinë dhe të kontribuojnë në sfidat kulinarie që do të organizohen gjatë aktivitetit.

8. Shkolla dhe studentët

Shkollat dhe studentët që do të përfshihen në aktivitete edukative dhe kulturore, përfshirë panairët dhe ekspozitat, si dhe sfidat që lidhen me zhvillimin e turizmit dhe artit.

Në një aktivitet kulturor, grupet e synuara përfshijnë komunitetin vendas, vizitorët e huaj, të rinjtë, profesionistët e fushës, familjet dhe aktorët e industrisë. Këto kategori luajnë rol të rëndësishëm në pasurimin e përvojës kulturore dhe në arritjen e objektivave të aktivitetit, duke krijuar hapësira për bashkëpunim, shkëmbim vlerash dhe zhvillim të përbashkët.

REZULTATET E PRITSHME

Ky aktivitet në Himarë, si pjesë e sezonit turistik, ka si qëllim të sjellë një zhvillim të ndjeshëm për rajonin jugor duke bashkuar artin, kulturën dhe turizmin në një ngjarje të pasur dhe dinamike. Ka potencialin për të sjellë një impakt të madh në zhvillimin e Himarës, duke tërhequr vizitorë, duke promovuar kulturën dhe natyrën dhe duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të rajonit. Disa prej rezultateve të pritura dhe ndikimeve të mundshme të këtij aktiviteti përfshijnë:

Promovimi dhe Nxitja e Turizmit të Qëndrueshëm:

Ngjarja do të shërbejë si një platformë e rëndësishme për të promovuar bukuritë natyrore, traditat dhe kulturën e Himarës, duke rritur vizibilitetin e saj në tregun turistik dhe duke tërhequr më shumë vizitorë gjatë dhe pas sezonit veror.

2. Zhvillimi Ekonomik i Rajonit Jugor:

Përmes aktiviteteve turistike, panairove të artizanatit dhe kulinarisë, si dhe përfshirjes së bizneseve lokale, parashikohet stimulim i tregtisë dhe rritje e mundësive për punësim dhe sipërmarrje në zonë.

Fuqizimi i Rinisë dhe Promovimi i Sportit:

Organizimi i aktiviteteve sportive dhe garave ujore do të përfshijë aktivisht të rinjtë, duke nxitur stilin e jetesës aktive, zhvillimin fizik dhe krijimin e frymës së bashkëpunimit dhe konkurrencës së shëndetshme.

Vlerësimi i Artit dhe Trashëgimisë Kulturore:

Ekspozitat artistike, aktivitetet kulturore dhe prezantimet tematike do të forcojnë identitetin kulturor të zonës, duke ofruar hapësira për artistët dhe duke tërhequr publik të interesuar për kulturën dhe historinë lokale.

Rritja e Pjesëmarrjes së Komunitetit:

Festivali do të shërbejë si një pikë bashkëpunimi për komunitetin lokal, duke i angazhuar banorët në organizim, promovim dhe pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme, çka rrit ndjenjën e përkatësisë dhe solidaritetit. Ky aktivitet do të krijojë mundësi për komunitetin lokal që të angazhohet në mënyra të ndryshme, si organizimin e panairove, sfidat e gatimit, dhe përfshirjen në aktivitete sportive. Kjo mund të ndihmojë në forcimin e bashkëpunimit dhe zhvillimin e lidhjeve më të forta brenda komunitetit.

Mbështetja e Artizanatit dhe Traditës së Kulinarisë:

Panairot do t'u japin prodhuesve lokalë, artizanëve dhe gastronomëve një mundësi për të prezantuar dhe tregtuar produktet e tyre, duke ndihmuar në promovimin e vlerave autentike të zonës dhe krijimin e një tregu të qëndrueshëm lokal. Ky aktivitet do të shërbejë si një platformë ideale për të promovuar prodhimet vendase dhe për të lidhur turistët me kulturën dhe gastronominë e Himarës, duke i kthyer ata potencialisht në konsumatorë dhe mbështetës të produkteve lokale. Një mundësi e veçantë do t'u ofrohet edhe artistëve himariotë, të cilët do të kenë shansin të ekspozojnë krijimtarinë, stilin dhe talentin e tyre, duke kontribuar në pasurimin kulturor dhe estetik të eventit.

Mbështetje për Inovacionin dhe Kreativitetin:

Me "Fun Kids Zone" paradën, konkursin, karnavalet verore si dhe për garat e gatimit, workshopet e artit dhe artizanatit, ky aktivitet ofron mundësi për krijimin dhe mbështetje të punëve kreative, duke inkurajuar pjesëmarrësit, sidomos fëmijëve dhe të rinjëve të shprehin talentet e tyre në forma të ndryshme.

AKTIVITETET

Ky aktivitet i sezonit turistik në Himarë është shumë i pasur dhe shumëdimensional, duke ofruar një shumëllojshmëri aktivitetesh që do të promovojnë turizmin, artin dhe kulturën lokale. Aktivitetet kryesore të këtij aktiviteti do të përfshijnë:

Parada e Bandës Filarmonike – Hapja Festive e Sezonit Turistik në Himarë

“ Parada e tingujve të detit, tingujt që zgjojnë Himarën”

Ky aktivitet synon të shënojë hapjen zyrtare të sezonit turistik në qytetin e Himarës përmes një parade të veçantë artistike me pjesëmarrjen e një bande filarmonike dhe një bande muzikore festive. Aktiviteti do të zhvillohet në rrugët kryesore të qytetit, ku muzikantët do të performojnë drejtpërdrejt duke krijuar një atmosferë energjike dhe festive që do të përfshijë të gjithë qytetin.

Parada muzikore do të nisë nga një pikë qendrore e Himarës dhe do të përshkojë zonat më të frekuentuara të qytetit, duke interpretuar repertor të larmishëm muzikor me ritme festive dhe këngë të njohura që synojnë të aktivizojnë dhe të ftojnë banorët dhe vizitorët të bëhen pjesë e festës. Përmes tingujve të instrumenteve frymore dhe ritmike, aktiviteti do të krijojë një atmosferë dinamike që simbolizon gjallërimin e qytetit dhe nisjen e një sezoni të ri turistik.

Qëllimi i kësaj parade është të krijojë një moment simbolik dhe spektakolar të hapjes së sezonit, duke bashkuar komunitetin lokal dhe turistët në një përjetim kulturor dhe artistik në hapësirë publike. Aktiviteti pritet të rrisë gjallërinë e qytetit, të promovojë identitetin kulturor të Himarës dhe të shërbejë si një ftesë e hapur për të gjithë vizitorët që të përjetojnë energjinë dhe mikpritjen e zonës. Nëpërmjet muzikës live dhe ndërveprimit me publikun, parada do të kthehet në një festë të hapur urbane që do të shpallë me entuziazëm fillimin e sezonit turistik në Himarë.

Ekspozita Dokumentare dhe fotografike “Himara – Rrëfimi ynë i lashtë, krenaria jonë e përjetshme”

Ekspozita dokumentare “Himara – Rrëfimi ynë i lashtë, krenaria jonë e përjetshme” synon të afrojë vizitorët me historinë dhe trashëgiminë kulturore të Himarës dhe zonave përreth. Ky është një udhëtim edukues që shpalos rrugëtimin e qytetit, duke treguar se si arti, natyra dhe jeta sociale kanë ndikuar në formimin e identitetit dhe zhvillimit turistik të tij ndër vite. Përmes vizatimeve artistike, pikturave dhe materialeve dokumentuese, vizitorët do të kenë mundësinë të zbulojnë autenticitetin dhe veçoritë unike të Himarës, duke parë evolucionin e saj nga e shkuara deri në ditët e sotme.

“Bukuria e Himarës” nuk qëndron vetëm te peizazhi, por edhe te forca e historisë së saj. Ne synojmë të sjellim në vëmendje rrënjët, traditat dhe mënyrën e jetesës së paraardhësve si një burim frymëzimi për të tashmen dhe të ardhmen. Kjo ekspozitë pritet të jetë një prej pikave më tërheqëse të aktivitetit, duke ofruar një përvojë të pasur kulturore për turistët vendas dhe të huaj dhe duke i mundësuar të njohin më thellë trashëgiminë mijërvjeçare të Himarës.

Fotografitë e përzgjedhura tregojnë jo vetëm peizazhin karakteristik të bregdetit jonian, por edhe historitë njerëzore që kanë formësuar identitetin e Himarës: peshkatarët tradicionalë, mjetet e hershme të peshkimit, momentet e jetës sociale dhe traditat që janë transmetuar ndër breza. Përmes kësaj ekspozite, vizitorët ftohen të udhëtojnë në kohë dhe të njohin transformimin e qytetit, nga një komunitet tradicional bregdetar drejt një destinacioni të rëndësishëm turistik. Fotografitë shërbejnë si dëshmi të gjalla të historisë lokale, duke ruajtur kujtesën kolektive dhe duke theksuar lidhjen e pandashme mes banorëve dhe detit.

Ekspozita ka një vlerë të veçantë kulturore dhe edukative, pasi ndihmon në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë historike të Himarës, duke ndërgjegjësuar veçanërisht brezat e rinj për rëndësinë e identitetit lokal. Njëkohësisht, ajo përbën një atraksion kulturor për vizitorët dhe turistët, duke kontribuar në promovimin e turizmit kulturor dhe historik të zonës dhe në forcimin e krenarisë komunitare. Në këtë mënyrë, ekspozita synon të krijojë një urë lidhëse mes së shkuarës dhe së tashmes, duke nxjerrë në pah historinë, kulturën dhe shpirtin e veçantë të qytetit të Himarës.

Himarë Street Food “ Shije Joniane”

Himarë Street food dhe demonstrimet e gatimit live “ **Shije Joniane**” do të krijojnë një përvojë të veçantë dhe interaktive për turistët gjatë çeljes së sezonit turistik. Vizitorët do të kenë mundësinë të shijojnë specialitetet tradicionale të Himarës, ndërsa paralelisht njohin teknikat, traditat dhe recetat autoktone të zonës.

Koncepti i finger food do t’u ofrojë turistëve një mënyrë të shpejtë, të thjeshtë dhe autentike për të provuar shijet karakteristike, pa pasur nevojë për shërbim të plotë restoranti. Ky aktivitet jo vetëm do të promovojë kulinarinë dhe kulturën vendase, por edhe do të ofrojë një eksperiencë të këndshme, të lehtë dhe të shijshme, duke pasuruar vizitën dhe angazhimin e publikut.

Konkurs Foto dhe Video “ Himare Magic Moments” / “Himara Through Your Lens”

Konkursi kombëtar i Fotografisë dhe Videove Reels për Himarën do të ofrojë mundësi për të promovuar bukurinë natyrore dhe kulturore të Himarës, duke inkurajuar vizitorët dhe artistët që të krijojnë dhe shpërndajnë përmbajtje që promovon zonën. Konkursi iu drejtohet gjithkujt që është magjepsur pas Himarës dhe ka memorizuar në aparatit e fotografisë foto dhe video, në çdo cep të saj gjatë viteve të fundit. Në këtë ngjarje të bukur do të shpallen disa çmime si:

2 çmime për fotot e reels-at më të mire (Tablet)

Panair Artizanati dhe Kulinarie:

Punë artizanale tradicionale shqiptare: Ekspozita ku do të shihen objekte të punuara me dorë, si punime qeramike, kostume popullore, punime në tezgjah, qilima, punime druri dhe mjete të tjera që përdoren në jetën e përditshme të Himarës.

Përgatitje e ushqimeve tradicionale himariote: Pjesëmarrësit do të shijojnë pjatat tradicionale të peshkut, frutave të detit, dhe do të shërbehen në mënyra tradicionale, duke përfshirë receta që janë përgatitur për breza të tërë. Gatimet tradicionale të Himarës dhe të gjithë Shqipërisë do të jenë një atraksion i rëndësishëm për vizitorët, duke ofruar mundësi për të shijuar ushqime dhe pije lokale. Panairi i kulinarisë do të sjellë pjesëmarrës të ndryshëm, përfshirë kuzhinierë të njohur dhe restorantet lokale.

Në këtë aktivitet do të promovohen biznese të ndryshme, ofj, gatime të ndryshme nga restorantet, bujtinat, kantina vere, zejtarë dhe artizanë të ndryshëm, biznese bio, kompani, institucione të ndryshme, SME të vogla dhe të mëdha, fondacione, biznese të zonës dhe biznese të rrethit të Himarës, të Qarkut të Vlorës edhe më gjërë, etj). Nëpërmjet këtij panairi ofrojmë një platformë prezantimi, komunikimi, shkëmbimi eksperiencë, prezantim oferte dhe kërkesë duke u dhënë mundësi bizneseve edhe artizanëve të reklamohen në këtë ngjarje kulturore.

Angazhimi i Fëmijëve dhe Familjeve “ FUN KIDS ZONE”

- Aktivitetet për fëmijët do të jenë të fokusuar në krijimin e një lidhje me traditat lokale. Ata do të angazhohen në aktivitete si:

- Krijimi i modeleve dhe materialeve artizanale që do të përdoren për çeljen e sezont turistk.

- Krijimi i pikturave, vizatimeve dhe krijimeve artistike novatore, duke lejuar fëmijët të lidhin pasionin e tyre me traditat dhe historinë e Himarës.

Këto ditë festive fëmijët do të kenë plot surpriza, facepainting, animatorë, etj.

Paradë e fëmijëve

Kompeticioni me Kostume Tradicionale Detare

Do të organizohet një konkurs festiv me kostume tradicionale detare, ku pjesëmarrësit do të prezantojnë veshjet autentike që reflektojnë historinë, kulturën dhe stilin e zonës bregdetare të Himarës. Ky aktivitet synon të rikthejë në vëmendje trashëgiminë e pasur të veshjeve lokale dhe lidhjen e tyre me identitetin detar të qytetit.

Në përfundim të kompeticionit, një juri profesionale do të vlerësojë kostumet dhe do të shpërblejë më të bukurat në disa kategori të veçanta, duke krijuar atmosferë festive dhe emocionuese për pjesëmarrësit dhe publikun. Ky event do të sjellë traditën në skenë në mënyrë magjepsëse, duke e kthyer atë në një atraksion kulturor për të gjithë vizitorët.

Karnaval Veror me Personazhe dhe Maskota Turistike

Karnavali veror do të sjellë një atmosferë festive dhe plot ngjyra, ku rrugët do të gjallërohen nga personazhe artistike dhe maskota turistike të inspiruara nga tradita, deti dhe identiteti kulturor i Himarës. Kjo paradë e veçantë do të sjellë gëzim, argëtim dhe energji pozitive për të gjitha moshat, duke krijuar momente të paharrueshme për vizitorët dhe komunitetin vendas. Maskotat simbolike dhe personazhet kreative do të shndërrojnë hapësirën publike në një skenë të gjallë verore, duke e bërë

karnavalin një pikë të fortë të eventit dhe një atraksion të vërtetë turistik, perfekt për foto, video dhe kujtime të bukura.

Parada e Varkave të Dekoruar – Boat Parade

Si pjesë e Çeljes së Sezonit Turistik në Himarë, do të organizohet një paradë unike e varkave të dekoruara, që do të sjellë ngjyra, kreativitet dhe argëtim në brigjet e Detit Jon. Varkat do të jenë të zbukuruar me motive artistike, elemente tradicionale dhe tematika të frymëzuara nga natyra dhe kultura e Himarës, duke krijuar një spektakël vizual për vizitorët dhe turistët. Pjesëmarrësit do të mund të shijojnë atmosferën festive duke ndjekur paradën nga bregu ose duke marrë pjesë me varkat e tyre, ndërsa muzikë live dhe animacione do të shoqërojnë marshimin e varkave në ujë. Ky aktivitet synon të përfshijë të gjitha grupmoshat dhe të krijojë momente të paharrueshme për familjet, të rinjtë dhe turistët, duke e kthyer paradën e varkave në një atraksion të vërtetë turistik dhe kulturor.

Sfida Gatimi:

- Sfida e gatimit do të jetë një aktivitet i festivalit, ku kuzhinierët lokalë dhe ata të ftuar do të konkurrojnë për të përgatitur pjatën më të shijshme tradicionale të Himarës. Duke nxjerrë një produkt turistik të ri dhe duke e përfshirë në menutë e restoranteve të Himarës.
- Vizitorët do të angazhohen në prova gatimi ku do të mësojnë teknikat e gatimit të peshkut, frutave të detit, duke përfshirë receta tradicionale dhe moderne.
- Degustime të pjatave të peshkut, frutave të detit, ku pjesëmarrësit do të shijojnë ushqimin e përgatitur dhe të votojnë për pjatën më të mirë.

Ky aktivitet do të ofrojë mundësi edhe për nxënësit e shkollave profesionale të turizmit për të treguar aftësitë e tyre dhe për të konkurruar në gatimet tradicionale dhe unike.

Shfaqje Filmi dhe Projeksione “ Open Kinema Himara ” :

“ Himara Night Cinema”

Në kuadër të çeljs së sezonit turistik aktiviteteve kulturore verore do të organizohet “Open Cinema Himara”, një kinema në ambient të hapur që synon të sjellë për banorët dhe turistët një përvojë artistike pranë detit. Në një hapësirë publike të qytetit do të vendoset ekran i madh ku do të shfaqen filma artistikë shqiptarë, dokumentarë, fima për fëmijë, dhe materiale arkivore që lidhen me historinë, kulturën dhe jetën e rivierës shqiptare.

Programi do të përfshijë filma të njohur të kinematografisë shqiptare, dokumentarë mbi natyrën dhe traditat e jugut, fima për fëmijë, si dhe pamje të jetës së përditshme të zonës së Himarës dhe rivierës. Ky aktivitet synon të krijojë një atmosferë kulturore dhe argëtuese në mbrëmjet verore, duke promovuar turizmin, historinë dhe identitetin kulturor të zonës.

Aktivitete Folklorike dhe Muzikore:

- Shfaqje muzikore dhe valle tradicionale: Grupi Folklorik i Himarës do të interpretojë këngë dhe valle popullore që pasqyrojnë traditat dhe jetën e dikurshme të banorëve të qytetit.

- Koncert muzikor dhe këngë popullore e iso që sjellin ritmet dhe meloditë tradicionale të këtij rajoni, duke krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe festive që lidh të kaluarën me të tashmen

Aktivitete Sportive dhe Gara në Det:

- Çelja e Sezonit Turistik “ Aty ku dielli prek detin”, do të organizohet në një thrialon, në të cilin do të zhvillohen aktivitete të ndryshme njëkohësisht në pikëstacione të ndryshme në të reja ditët.

Mini-maratona “ Vrapo për Himarën”

“ Himara RunFest”

Mini-maratona është një aktivitet sportiv dhe social që synon të promovojë stilin e jetesës aktive, bashkëpunimin mes të rinjve dhe promovimin e bukurive natyrore të qytetit të Himarës. Ky aktivitet do të organizohet në bashkëpunim me studentët e Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali” dhe të rinjtë e komunitetit himariot.

Mini-maratona “ Himara RunFest” do të zhvillohet në një itinerar simbolik përgjatë qytetit të Himarës, duke përfshirë një distancë të përshtatshme për pjesëmarrjen e të rinjve dhe publikut të gjerë. Qëllimi i aktivitetit është të nxisë sportin, frymën e garës së shëndetshme dhe ndërveprimin mes studentëve dhe komunitetit lokal. Në aktivitet pritet të marrin pjesë dhjetëra studentë dhe të rinj, të cilët do të vrapojnë në një atmosferë festive dhe motivuese. Në përfundim të garës do të shpallen fituesit e vendeve të para, të cilët do të vlerësohen me çmime simbolike dhe certifikata pjesëmarrjeje. Përveç aspektit sportiv, mini-maratona do të shërbejë edhe si një aktivitet që promovon turizmin dhe jetën aktive në qytetin e Himarë, duke krijuar një moment bashkimi për komunitetin dhe duke nxitur angazhimin e të rinjve në aktivitete pozitive. Nëpërmjet këtij aktiviteti synohet të krijohet një traditë vjetore sportive që forcon lidhjet mes studentëve, të rinjve dhe komunitetit lokal, duke e kthyer Himarën në një hapësirë ku sporti dhe komuniteti bashkohen

Scuba Diving – Eksperiencë Nën ujë në Bregdetin Jonian Shqiptar

“Secrets under the Sea”

Ky aktivitet synon krijimin dhe promovimin e një qendre zhytjeje (Scuba Diving) që ofron eksperiencë të paharrueshme nën ujë për vizitorët dhe turistët që frekuentojnë bregdetin shqiptar. Aktiviteti do të jetë i hapur për pjesëmarrës të të gjitha niveleve, duke filluar nga fillestarët që dëshirojnë të provojnë për herë të parë zhytjen, deri tek zhytësit e certifikuar që kërkojnë të eksplorojnë më thellë pasuritë detare të deteve Jon dhe Adriatik.

Përmes instruktorëve të licencuar dhe pajisjeve profesionale, pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të përjetojnë nga afër biodiversitetin detar, shpellat nën ujë, relievin unik të bregdetit si dhe mbytyjet historike që gjenden në ujërat shqiptare. Aktiviteti do të zhvillohet duke respektuar standardet ndërkombëtare të sigurisë dhe duke promovuar një turizëm të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm ndaj mjedisit detar. Qendra e zhytjes synon gjithashtu të rrisë ndërgjegjësimin për mbrojtjen e ekosistemit detar dhe të pasurojë ofertën turistike të zonës, duke e kthyer zhytjen në një atraksion të rëndësishëm për turizmin aventurier në Shqipëri. Përmes këtij aktiviteti , vizitorët do të kenë mundësinë të zbulojnë një dimension të ri të bregdetit shqiptar – thesaret e tij të fshehura nën dallgë në bregun himariot.

Aktivitet me Jetski

“JetAdrenalin Himarë”

Ky aktivitet ofron një përvojë të organizuar dhe të sigurt me jetski, duke synuar të promovojë turizmin aktiv dhe sportiv në Himarë. Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të eksplorojnë bregdetin nën udhëzimin e instruktorëve të certifikuar dhe të sfidojnë njëri-tjetrin në gara të organizuara me kategori të ndryshme, duke nxitur konkurrencën sportive dhe përfshirjen e komunitetit.

Gara do të zhvillohet sipas rregullave standarde të sigurisë dhe me monitorim të vazhdueshëm, duke garantuar një aktivitet profesional dhe tërheqës për të gjitha moshat. Aktiviteti gjithashtu përfshin mbulim mediatik dhe çmime simbolike për fituesit, duke rritur vizibilitetin e Himarës si destinacion turistik aktiv.

Turneu i Kampionatit të Beach Volley në Himarë

“ Himare Beach Volley Challenge 2026”

Në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Volejbollit, organizojmë një turne profesional beach volley në plazhet e Himarës, i hapur për katër çifte meshkuj dhe katër çifte femra. Ky kampionat ka për qëllim të promovojë sportin, aktivitetin fizik dhe turizmin në zonën bregdetare, duke krijuar një ambient konkurrues dhe argëtues për sportistët dhe vizitorët.

Pjesëmarrësit do të garojnë për tre çmime me vlera të konsiderueshme, duke nxitur konkurrencë të shëndetshme dhe motivim për performancë të lartë. Turneu do të zhvillohet sipas rregullave profesionale të volejbollit dhe do të sigurojë një spektakël tërheqës për publikun dhe komunitetin lokal. Ky aktivitet gjithashtu kontribuon në promovimin e Himarës si destinacion turistik dhe krijon mundësi për përfshirjen e sponsorizimeve dhe mbulimit mediatik, duke forcuar lidhjen midis sportit, kulturës dhe turizmit.

Nëpërmjet këtij aktiviteti ne synojmë:

Integrimin e Detit në funksion të turizmit krahas mundësisë për të nxitur sportin;

Gjallërimin e jetës sportive në Himarë;

Promovimin e sportit si instrument edukues;

Synojmë të mbështesim profesionistët kombëtarë të Kanotazhit, Pack Rafting dhe Notit; Synojmë të promovojmë zonën e Himarës.

Aktivitete Interaktive për Vizitorët:

- Workshop-e dhe aktivitete edukative për të rinjtë dhe turistët, ku ata do të mësojnë për teknikat e gatimit, sportet ujore, aktivitetet sportive, dhe artizanatin tradicional.

Konkurs dhe Çmime:

- Çmime për garat sportive, sfidat e gatimit, Fun Kids Zone, si dhe aktivitete të tjera, që do të ofrojnë mundësi për pjesëmarrësit të festojnë arritjet e tyre.

Promovimi i Turizmit:

Ky aktivitet synon promovimin e turizmit në Himarë përmes broshurave informative dhe paketave turistike të personalizuar. Përmes aktiviteteve kulturore, sportive dhe aventurë, si festivali

i dritave, turneu i beach volley, mini-maratona, aktivitete me jetski dhe zhytje, si dhe ekspozita dhe kinema verore, aktiviteti synon të rrisë vizitueshmërinë, të zhvillojë ekonominë lokale dhe të pozicionojë Himarën si destinacion unik për turistët vendas dhe të huaj.

Aktivitete Sfiduese – Çelja e Sezonit Turistik në Himarë

Gjatë çeljes së sezonit turistik në Himarë, vizitorët do të përjetojnë një spektakël të jashtëzakonshëm përmes aktiviteteve sfiduese të organizuara me artistë të njohur, si nga Shqipëria, ashtu edhe nga skena ndërkombëtare. Programi do të përfshijë akrobaci mahnitëse që sfidojnë gravitetin, performanca dramatike me flakë që ndezin imagjinatën, si dhe sfida të jashtëzakonshme në lartësi të mëdha, dhe aktivitete me parashutë, ku të guximshmit mund të ndihen si fluturues në qiellin e Himarës duke krijuar një atmosferë adrenalike dhe emocionale për të gjithë publikun. Një moment kulmor i eventit do të jetë përpjekja për rekordin Guinness, e cila do të tërheqë vëmendjen e publikut dhe do të bëjë hapjen e sezonit një ngjarje unike dhe globale. Përveç këtyre atraksioneve, vizitorët do të përjetojnë surpriza të tjera interaktive dhe emocionuese që do të shtojnë adrenalinë, energji dhe një ndjesi të veçantë të pjesëmarrjes.

Përveç këtyre atraksioneve, vizitorët do të kenë mundësinë të përjetojnë surpriza të ndryshme, interaktive dhe kreative, të cilat do të shtojnë energji, emocion dhe një ndjesi të veçantë të pjesëmarrjes në një event unik turistik. Ky spektakël synon të bëjë hapjen e sezonit një eksperiencë të paharrueshme, duke kombinuar argëtimin, artin dhe aventurën në një format të organizuar profesionalisht. Gjatë çeljes së sezonit turistik në Himarë do të organizohen aktivitete sfiduese me artistë të njohur, si nga Shqipëria ashtu edhe nga jashtë saj. Publiku do të ketë mundësinë të shijojë akrobaci mahnitëse, performanca me flakë, sfida të jashtëzakonshme në lartësi të mëdha, etj. Përveç këtyre, vizitorët do të përjetojnë edhe shumë surpriza të tjera që do të shtojnë emocionin dhe energjinë e eventit. Ky spektakël kombinon argëtimin, artin dhe aventurën në një format profesional, duke e bërë hapjen e sezonit në Himarë një eksperiencë të paharrueshme për të gjitha moshat.

Light Festival – Festivali i Dritave, Himarë

“Light Festival” në Himarë do të sjellë një përvojë unike vizuale dhe kulturore mbi bregdetin e këtij qyteti të mrekullueshëm. Ngjarja kryesore e festivalit është “Feneri i Qiellit”, ku të gjithë pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të ndezin fenerët e tyre, duke i ngritur ngadalë në qiell. Ky spektakël i dritës simbolizon shpresën, dëshirën dhe fillimin e ëndrrave të reja, duke transformuar natën në një panoramë magjike dhe të paharrueshme.

Në det do të vendosen varka të ndriçuara, të cilat do të qëndrojnë si dekor unik gjatë gjithë aktivitetit, duke krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe tërheqëse për vizitorët. Komunikimi i dritave të fenerëve me dritën e varkave dhe anijeve të ankoruara pranë liqenit do të formojë një skenë vizuale të jashtëzakonshme dhe të paharrueshme. “Light Festival” synon të krijojë një traditë të re në Himarë, duke e bërë këtë ngjarje një simbol të dritës, shpresës dhe bashkëjetesës kulturore, që do të përsëritet çdo vit dhe do të mbetet një kujtim i paharrueshëm për të gjithë pjesëmarrësit.

Koncert:

Çelja e Sezonit Turistik “Aty ku dielli prek detin”

Çelja e sezonit turistik në Himarë, nën moton “Aty ku dielli prek detin”, premtan të jetë një ngjarje madhështore dhe e paharrueshme që do të bashkojë artin, kulturën, sportin dhe traditat vendase në një përvojë unike për vizitorët vendas dhe të huaj. Ky event do të sjellë në një skenë të përbashkët emrat

